



**PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

Nr. 23

Datë: 08. 05. 2020. Ora: 11:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Sami Hamiti, Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Eshref Vishi, Nenad Rikalo, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Artan Asllani.

SKQZ: Yll Buleshkaj, u.d. i Kryeshefit

Përkthyes: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

**RENDI I DITËS**

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit vjetor të punës i KQZ-së 2019, për Kuvendin e Republikës së Kosovës.
3. Raporti i Këshillave të KQZ-së:

**Këshilli për Çështje Ligjore:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtares të kuvendit komunal në Gjakovë.

4. Të ndryshme.
- 

*(p.s. Kjo mbledhje, për arsye të pandemisë Kovid – 19, realizohet në mënyrë teknologjike, përmes sistemit “Skype” – Internet)*

---

**1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:**

**Valdete Daka:** Mundemi me ja filluar! Përshëndetje të gjithëve, është kjo mbledhja 23 e KQZ. Do të duhet ta kemi edhe një pikë të Këshilli për Çështje Ligjore. Në mbledhje prezantojnë të gjithë anëtarët, prandaj kush është për këtë rend dite...? Anëtarët e KQZ-së, me 11 vota për, miratuan rendin e ditës.

## **2. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit vjetor të punës i KQZ-së 2019, për Kuvendin e Republikës së Kosovës.**

**Valdete Daka:** Sipas rregullave, ne duhet ta dërgojmë një raport dhe këtë raport e ka përgatitur Sekretariati së bashku me menaxhmentin. E keni pasur në imel. Dhe, nëse ka dikush vërejtje në këtë raport, ju lutem deklarojuni.

**Sami Hamiti:** Para se të fillojmë shqyrtimin, e raportit deshta të them se pjesa e aneksit që, është “ Raporti financiar për vitin 2019”, të mos shqyrtohet sot, sepse së bashkë me krye shefin dhe drejtoreshën, jemi akorduar që duhet të ketë intervenime, të përmirësohet sepse, për kohë të shkurtër nuk mund të rregullohet dhe kjo, të shqyrtohet në një mbledhje tjetër të këshillit. Janë të pashmangshme disa përmirësime, dhe kërkoj që të hiqet, pra vetëm pjesa e aneksit të raportit financiar.

**Valdete Daka:** Konsideroj edhe unë që ajo pjesë duhet të ketë përmirësime, dhe si e tillë nuk ish dashur të shqyrtohet sot.

**Alim Rama:** Edhe raporti, nuk mundet me u trajtua sikur i mirëqenë dhe që të shqyrtohet, dhe pas vërejtjeve të aprovohet. Unë, në fillim mendoj se kam problem sepse, në esencë, duhet ta shqyrtojmë dhe se nuk mund të aprovohet në mënyrë automatike. Raporti, ka mangësi, interferim ! Raporti na është dërguar me vendim që na ta aprovojmë ...!

**Valdete Daka:** Ne materialin e dërgojmë së bashku me vendimin, mirëpo vendimi nënshkruhet mbasi që të aprovohet nga KQZ...

**Alim Rama:** Në vend të raportit si dokument, unë më shumë isha ndalur te dëshira se cka ka punuar KQZ-ja...Raporti, nuk bënë kurrfarë krahasimi se çka është realizuar në bazë të planit të punës dhe ne, as nuk mundemi me ditë se nuk e kemi pa planin e punës 2019. Raporti në asnjë pikë nuk trajton se cilat janë kanë synimet e KQZ –së 2019, dhe cka është realizuar prej atyre synimeve !

**Valdete Daka:** Problemi është se ne “2019”-in, e kemi filluar në prill, tash një vit...

**Sami Kurteshi:** Kam një propozim – shkurtë: mendoj se është problematike që të diskutojmë përmes “skaybit” për raportin, dhe unë propozoj që, javën e ardhshme ta mbajmë një takim në selinë e KQZ-së, duke iu përmbajtur masave të sigurisë, distancës...Të jemi aty, të dëgjohemi mirë, dhe t’i japim vërejtjet konkrete..

**Yll Buleshkaj:** Më lejoni t’i japë disa shpjegime: ky raport, është dashur të dorëzohet në fund të muajit të kaluar, por për shkak të gjendjes nuk është kryer me kohë... Jemi vonë, por ne kemi arritur që t’ua dërgojmë juve sepse, nuk është menduar që të dërgohet për shkak të rrethanave shpejt e shpejtë... Struktura e raportit i përshtatet kornizës – një skeleti sipas kërkesës së Kuvendit, dhe ne nuk mundemi me ba shumë

ndryshime...Jemi pajtuar edhe me z. Samiu që pjesa financiare të rishikohet edhe njëherë...Pjesa narrative është e shkruar qartë për detajet...dhe, nuk ceket çdo detaj...Kështu që raporti, i përmban elementet sipas kërkesave të Kuvendit...Por, si të vendosni ju...!?

**Valdete Daka:** Nuk më kujtohet që ne e kemi aprovuar planin 2019, dhe se në prill menjëherë kemi shkaur me zgjedhje në komunat e Veriut, dhe pastaj me zgjedhjet parlamentare dhe nuk e di nëse jemi marrë fare me planin e punës...Kështu që ky raport pasqyron dy palë zgjedhje, dhe ne nuk kemi arritur të bëjmë tjetër...

**Sami Kurteshi:** Raporti vjetor, është dokumenti kryesorë... (nuk kuptohet...). Problemi i diskutimit në skaib, është i mangët... (nuk kuptohet)...Unë propozoj që ta lëmë për mbledhjen e ardhshme kurse sot, s'mund ta miratojmë....Sot, mund të vazhdojmë me pikën tjetër...(nuk kuptohet)...

**Arianit Elshani:** Pajtohem me Samiun që raportin ta lëmë për një mbledhje tjetër në javën e ardhshme, të hënën...nëse jemi dakord të gjithë... (nuk kuptohet )...mund ta shqyrtojmë më mirë, dhe të kemi mundësi që secili anëtar i KQZ –së t'i jep inputet e tij lidhur me këtë raport të Kuvendit...

**Valdete Daka:** Të martën, sepse të hënën nuk punohet... Në rregull, nëse pajtoheni e shtyjmë këtë pikë...

**Eshref Vishi:** Teknikisht, sepse unë nuk dëgjoj fare, ta lëmë për mbledhjen tjetër...

**Valdete Daka:** E lëmë për të martën të takohemi në selinë e KQZ-së... Dhe, vazhdojmë tani me pikën e dytë...

### **3.Raporti i Këshillave të KQZ-së:**

#### **Këshilli për Çështje Ligjore:**

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtares të kuvendit komunal në Gjakovë.

**Arianit Elshani:** Këshilli për Çështje Ligjore, ka shqyrtuar kërkesën lidhur me zëvendësimin e anëtares së Kuvendit Komunal në Gjakovë, Arieta Gjoka e cila ka qenë deri më tani anëtare e kuvendit, që të zëvendësohet me Teuta Gjinin. Pas shqyrtimit të gjithë dokumentacionit dhe aprovimit të kësaj kërkesë në këshill, është proceduar për këtu në KQZ, dhe ne rekomandojmë për aprovim të këtij zëvendësimi...

**Valdete Daka:** Atëherë, kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, me 11 vota për, miratuan këtë zëvendësim...

**Valdete Daka:** Në fund, kisha me ju informuar se na ka ardhur draft - raporti i Auditorit, dhe se shpejti do të na dërgohet edhe raporti final. Pra, na është dhënë afati që

ne ti dërgojmë vërejtjet tona. Raporti, mund të them që është goxha i mirë, dhe se presim po këtë vlerësim edhe në tekstin final...

**Nenand Rikallo:** Dëgjohemi...? Kam një pyetje... ( nuk dëgjohet...)

**Yll Buleshkaj:** Nuk dëgjohet z. Rikallo, por nëse pyetja është urgjente, dërgoheni me shkrim, nëse nuk është urgjente lejeni për të martën...

Nëse nuk kemi diçka tjetër, propozoj që të takohemi në mbledhjen e ardhshme në ora 13:00, të martën...

## 5. **Të ndryshme.**

**Alim Rama:**